



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 24 qershor 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1515_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 dhe 1.12, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, Nenin 30, Nenin 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 34 dhe Nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Ligji Nr.04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë;
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Ligji Nr. 05/L - 069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike në anën tjetër;
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- "Marrëveshjen për Energji" ("Aranzhimeve për Energji") të vitit 2013;
- "Konkluzionet e Lehtësuesit të BE mbi Implementimin e Marrëveshjes për Energji të vitit 2013" të vitit 2015;
- Udhërrëfyesin për Zbatimin e Marrëveshjeve të Energjisë e datës 21.06.2022; dhe
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Furnizimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.12.2020 nga subjekti juridik "Drustvo Elektroserver" D.O.O, adresa: "Filip Visnjic" B.B., Mitrovica e Veriut, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 24 qershor 2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. I LËSHOHET LICENCA** për Furnizim me energji elektrike ndërmarrjes "Drustvo Elektroserver" D.O.O, me numër Licence ZRRE/ Li_70/20, për periudhën pesë (5) vjeçare, e cila do mbulojë periudhën nga data 24 qershor 2022 deri më 23 qershor 2027.



- II. Territori që mbulohet me këtë Licencë janë konsumatorët e katër (4) Komunave veriore të Republikës së Kosovës dhe atë: Mitrovica Veriore, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 5 të "Marrëveshjes për Energjinë" të vitit 2013.
- III. Brenda shtatë (7) ditëve nga lëshimi i licencës për furnizim, "Drustvo Elektroserver" D.O.O do t'i siguroj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) të dhënat më të fundit të disponueshme për konsumatorët, nëpërmjet BE-së.
- IV. Brenda dhjetë (10) ditëve nga data e lëshimit të Licencës për furnizim, "Drustvo Elektroserver" D.O.O do të nënshkruaj me KOSTT dhe KEDS marrëveshjet e domosdoshme teknike për të operuar në tregun e energjisë në Kosovë, d.m.th. Marrëveshjen Kornizë për Aderim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike me KOSTT-in, Marrëveshjen mbi Detyrimet e Balancimit me KOSTT-in, Marrëveshjen e Kçjes me KEDS-in, dhe Marrëveshjen Komerciale me KEDS-in për ofrimin e shërbimeve të distribuimit (faturimi, arkëtimi, mirëmbajtja dhe lidhjet fizike të konsumatorëve të rinj) në katër (4) komunat veriore me shumicë serbe, sipas Nenit 5 të Marrëveshjes së 2013.
- V. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjeve të nevojshme teknike me KOSTT sipas dispozitivit nën pikën IV. të këtij Vendimi, "Drustvo Elektroserver" D.O.O do të marrë Kodin e Identifikimit të Energjisë (EIC) për të kryer aktivitetet e parashikuara nga licenca për furnizim.
- VI. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lëshimit të Licencës për furnizim, në përputhje të plotë me Nenin 14 të Konkluzioneve të vitit 2015 mbi implementimin e Marrëveshjes së Energjisë së 2013, KOSTT dhe KEDS (nën Lehtësimin e BE-së, nëse kërkohet) do të ketë qasje të plotë në nënstacionin Vallaq-Nallaq, si dhe në infrastrukturën tjetër të transmetimit dhe shpërndarjes.
- VII. Brenda katërdhjetë e pesë (45) ditëve nga data e lëshimit të Licencës për furnizim, KOSTT dhe KEDS pas konsultimit me "Drustvo Elektroserver" D.O.O do të dorëzojnë në ZRRE planet e investimeve dhe kostot e kërkuara të mirëmbajtjes dhe humbjet në rrjet, bazuar në shqyrtimin e plotë të infrastrukturës ekzistuese.
- VIII. Brenda njëzet e një (21) ditëve pas dorëzimit të planit të investimit, shpenzimeve të kërkuara të mirëmbajtjes e humbjeve të rrjetit, sipas dispozitivit nën pikën VII. të këtij Vendimi, ZRRE do t'i aprovojë në parim këto plane, kostot dhe humbjet.
- IX. Në rast se kërkesat e cekura më lartë nuk përmbushen pas njëqind (100) ditëve nga data e lëshimit të Licencës për furnizim, ZRRE do ndërmarr të gjitha veprimet ligjore të pezulloj dhe/ose tërheq licencën për furnizim për "Drustvo Elektroserver" D.O.O sipas legjislacionin në fuqi, në pajtim me pikën 8 të Udhërrëfyesit për Zbatimin e Marrëveshjeve të Energjisë, e datës 21.06.2022.

ARSY ET IM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 28.12.2020, nga "Drustvo Elektroserver" D.O.O. ka pranuar Aplikacionin për Licencë për Furnizim me Energji Elektrike në Kosovë, me dëshmitë përkatëse që kërkohen me aplikacion.



- Me Aplikacionin në fjalë “Drustvo Elektroserver” D.O.O ka kërkuar që të ushtroj aktivitetin e furnizimit me energji elektrike vetëm të katër komunave në veri të Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me Pikën 5 të “Marrëveshjes për Energji” të vitit 2013.
- “Marrëveshja për Energji” e lidhur në vitin 2013 mes Kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë, dhe “Konkluzionet e lehtësuesit të BE mbi implementimin e Marrëveshjes për Energji të vitit 2013” përveç lëshimit të Licencë, përcaktojnë edhe obligime tjera të vendosura si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- Udhërrëfyesi i Zbatimit të Marrëveshjeve të Energjisë i datës 21.06.2022 me qëllim të tejkalimit të krizës dhe problemeve në sektorin e energjisë, duke marr parasysh Marrëveshjet në Lidhje me Energjinë e datës 08 shtator 2013 (Marrëveshja e Energjisë 2013) dhe Konkluzionet e Lehtësuesit të BE-së, për zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë të vitit 2013, e datës 25 gusht 2015 (Marrëveshja e Energjisë 2015), me të cilën palët janë patuar për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga këto marrëveshje.
- ZRRE ka vlerësuar aplikacionin e “Drustvo Elektroserver” D.O.O me dëshmitë përkatëse, dhe pas disa komunikimeve me aplikuesin për t’i përmirësuar/plotësuar dëshmitë e aplikacionit, ka vlerësuar se aplikacioni është i kompletuar.
- Ashtu siç kërkohet me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, “Drustvo Elektroserver” D.O.O ka dëshmuar se ka bërë njoftimin e publikut të gjerë dhe palëve të interesit përmes portaleve elektronike në gazetatat ditore Zëri dhe Koha Ditore.
- ZRRE brenda afatit të dhënë me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë nuk ka pranuar asnjë ankesë/kundërshtim nga ndonjë palë e interesit.
- ZRRE në përputhje me Rregullën për Licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron administrativisht i kompletuar, por fillimisht për shkak të mungesës së kuorumit të Bordit të ZRRE, por edhe specifikave të trajtuara në dispozitiv të këtij Vendimi e të cilat specifika kanë qenë objekt i bisedimeve në Bruksel, kanë ndikuar që ky Vendim nuk ka mundur të bëhet deri me datën e nxjerrjes së këtij Vendimi.
- Në dispozitivin e këtij Vendimi janë përfshirë edhe obligimet që “Drustvo Elektroserver” D.O.O dhe akterët tjerë të përfshirë me Marrëveshje dhe Konkluzia, duhet ti përmbushin brenda afateve të përcaktuara si në dispozitiv, e të cilat obligime janë pjesë përbërëse e “Marrëveshjes për Energji” e vitit 2013 dhe “Konkluzioneve të Lehtësuesit të BE mbi Implementimin e Marrëveshjes për Energji të vitit 2013” të vitit 2015, dhe Udhërrëfyesit të Zbatimit të Marrëveshjeve të Energjisë e datës 21.06.2022.
- Obligimet dhe afatet e përmbushjes së tyre të cekura në dispozitiv të këtij Vendimi janë të domosdoshme në mënyrë që Operatorët e Rrjeteve (KOSTT dhe KEDS) të kenë qasje në pjesën veriore të Kosovës për ti regjistruar asetet e transmisionit dhe distribuimit dhe gjendjen e atyre asetëve; ti kenë regjistrat e konsumatorëve shtëpiak dhe jo shtëpiak si dhe profilin e konsumit të energjisë elektrike të atyre konsumatorëve, në mënyrë që të mund ti përgatisin planet afatshkurtra dhe afatmesme investive në rrjetet e transmisionit dhe distribuicionit.
- Të dhëna e cekura më lartë janë të domosdoshme për KOSTT dhe KEDS edhe për operimin dhe mirëmbajtjen e atyre asetëve për t’ju mundësuar kyçjen e konsumatorëve të rinj në ato asete,



planifikimin e balenceve te energjisë për tërë sistemin, për kalkulimin e kërkesës dhe humbjeve të energjisë në rrjet etj.

- Të dhënat/Regjistrat e konsumatorëve të kërkuara si në dispozitiv të këtij Vendimi janë të domosdoshëm në mënyrë që OSSH ti regjistroj në qendrën e dhënave për konsumatorë si dhe KOSTT për ti regjistruar këta konsumatorë në bazën e të dhënave AMM (Agjent për Administrimin e Matjeve) përgjegjëse për udhëheqjen e procesit të ndërrimit të furnizuesit.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të dëshmimeve të kërkuara me aplikacion e të përcaktuara sipas Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, vlerësimit të kushteve të përcaktuara nga Marrëveshja për Energji ("Aranzhimeve për Energji") të vitit 2013, "Konkluzionet e lehtësuesit të BE-së mbi Implementimin e Marrëveshjes për Energji të vitit 2013" të vitit 2015, dhe Udhërrëfyesit të Zbatimit të Marrëveshjeve të Energjisë e datës 21.06.2022, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

X. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

XI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Shoqërisë "Drustvo Elektroserver"D.O.O,
- Zyrës së BE-së,
- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- KOSTT,
- KEDS,
- KESCO,
- KEK SH.A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.